

VENDIM
Nr.403, datë 9.6.2005

PËR CAKTIMIN E KOMISIONEVE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË SHQYRTIMIT DHE KORRESPONDENCËS PËR DHËNIE DHE RINOVIM LICENCASH, AUTORIZIMESH DHE MIRATIMESH NGA AUTORITETI MBIKËQYRËS I SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti Mbiqëqyrës i Sigurimeve zbaton komisione për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit, shërbimeve aktuariale në sigurime dhe risigurime.

2. Komisionet caktohen për përballimin e shpenzimeve të përpunimit, zhvillimit të korrespondencës për verifikimin e saktësisë dhe plotësimit të dokumentacionit të paraqitur për marrje apo rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh.

3. Për marrje licence për ushtrim veprimtarie, si shoqëri sigurimi, zbatohen komisionet si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh;

b) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën angleze, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekësh;

c) Për dhënie licence për ushtrim veprimtarie sigurimi, çdo shoqëri e licencuar derdh, në çastin e marrjes së licencës, në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

4. Për marrje licence për zgjerim veprimtarie sigurimi të shoqërisë së sigurimit apo të degës së shoqërisë së huaj të sigurimit zbatohet komisioni prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, në çastin e marrjes së licencës.

5. Për marrje licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e agentit në sigurime apo dega e shoqërisë së huaj të agentit zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 2000 (dy mijë) lekësh;

b) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën angleze, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 3 000 (tre mijë) lekësh;

c) Për dhënie licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e agentit apo dega e shoqërisë së huaj të agentit, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh;

ç) Për rinovim licence të shoqërisë së agentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës së rinovuar, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

6. Për licencimin e agentit në sigurime zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënien e licencës së agentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh;

c) Për rinovim licence të agentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës së rinovuar, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 5000 (pesë mijë) lekësh.

7. Për marrje licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e brokerimit apo dega e shoqërisë së huaj të brokerimit zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve shumën prej 2000 (dy mijë) lekësh;

b) Për tërheqjen e dokumentacionit në gjuhën angleze, çdo subjekt i interesuar duhet të derdhë

në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 3000 (tre mijë) lekësh;

c) Për dhënie licence për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi nga shoqëria e brokerimit apo dega e shoqërisë së huaj të brokerimit, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh;

ç) Për dhënie autorizimi brokerit në sigurime, në çastin e marrjes së autorizimit, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh.

8. Për dhënie autorizimi aktuarit në sigurime zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënie autorizimi, në çastin e marrjes së autorizimit, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

9. Për licencimin e vlerësuesit të dëmeve zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënie licence vlerësuesit të dëmeve, në çastin e marrjes së licencës, derdhet në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

10. Për licencimin e konsulentëve në sigurime zbatohen komisionet, si më poshtë vijon:

a) Për tërheqjen e dokumentacionit, çdo person i interesuar duhet të derdhë në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shumë prej 1000 (një mijë) lekësh;

b) Për dhënie licence konsulentit në sigurime, në çastin e marrjes së licencës, derdhet, në llogarinë bankare të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

11. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve zbaton komisione në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për dhënie miratimi, për:

a) ushtrim veprimtarie të shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) hapje zyre përfaqësimi të shoqërisë së huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) bashkim ose ndarje të shoqërisë së sigurimit;

ç) dhënie në sipërmarrje të disa funksioneve të shoqërisë së sigurimit.

12. Komisionet e parashikuara në këtë vendim janë të pakthyeshme.

13. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano